

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Liria e Lëvizjes

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohej hyrja në Republikën e Kosovës.
4. Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.
5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Constitutional Paragraph: Neni 35 para. 2

2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 5 (ç)

Të drejtat e tjera civile,

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor

i) E drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti;

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor

ii) E drejta e largimit nga çdo vend, duke përfshirë edhe vendin e vet, dhe e rikthimit në vendin e vet;

iii) E drejta e një shtetësie;

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 12.1

1. Secili që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti ka të drejtë të lëvizë lirisht brenda këtij territori si dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

Instrumentet ndërkombëtare

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Nenet

Neni 12.2

2. Secili është i lirë të braktisë cilindo vend, duke përfshirë edhe vendin e tij.

Neni 12.3

3. Të drejtat e sipërmendura mund të kufizohen vetëm kur kjo parashikohet me ligj, dhe kur është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin ose moralin publik ose të drejtat dhe lirinë e të tjerëve, si dhe kur këto kufizime janë në përputhje me të drejtat e tjera të njohura në këtë Pakt.

Neni 12.4

4. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga e drejta për të hyrë në vendin e tij.

Neni 2 Protokoli Nr.4

Liria e lëvizjes

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.

3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuar nga interesi publik në një shoqëri demokratike.

Neni 13.

1. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.

2. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilindo vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 18

Liria e lëvizjes dhe Kombësia

1. Shtetet Palë do të njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për lirinë e lëvizjes, lirinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre dhe kombësinë, njësoj si pjesa tjetër e popullësisë, duke u siguruar gjithashtu që personat me aftësi të kufizuar:

(a) të gëzojnë të drejtën për të marrë dhe ndryshuar kombësinë dhe që atyre të mos iu hiqet kombësia në mënyrë arbitrare apo për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar;

(b) të mos iu hiqet mundësia, për shkak të aftësisë së kufizuar, për të marrë, patur dhe përdorur dokumentacionin e kombësisë së tyre apo dokumentacion tjetër identifikues, apo për të përdorur proceset përkatëse të tilla si procedurat e emigrimit, që mund të nevojitet për të lehtësuar ushtrimin e të drejtës për lirinë e lëvizjes;

(c) të jenë të lirë të largohen nga çdo vend/shtet, përfshirë dhe vendin/shtetin e tyre;

(d) të mos iu hiqet e drejta, në mënyrë arbitrare apo për shkak të aftësisë së kufizuar për të hyrë në vendin/shtetin e tyre.

2. Fëmijët me aftësi të kufizuar do të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe që nga lindja do të kenë të drejtën për një emër, të drejtën për të marrë një kombësi dhe sa më shpejtë të jetë e mundur të drejtën për të njohur dhe për të patur kujdesin prindëror.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin Opsional
Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollin Opsional

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore
Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 2.1

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të /igjshme në territorin e një Shteti ka të drejte, brenda këtij territori, të Levizet lirisht në të dhe të zgjedhe lirisht vendbanimin e tij.

Instrumentet ndërkombëtare**Nenet**

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 2.2

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

2. Cdo person eshte i lire te /argohet nga cdo vend, duke perfshire te tijin.

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 2.3

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

3. Ushtrimi i ketyre te drejtave nuk mund te behet objekt i kufizimeve te tjera nga ate te parashikuara ne ligj dhe te domosdoshme ne nje shoqeri demokratike per sigurimin kombetar ose sigurine pub/ike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave pena/e, mbrojtjen e shendetit apo te moralit, ose mbrojtjen e te drejtave dhe te lirive te te tjereve.

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 2.4

Protokolli Nr. 4 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

4. Te drejtat e parashtruara ne paragrafin 1, ne disa fusha te caktuara, mund t'u nenshtrohen disa kufizimeve te vendosura ne perputhje me ligjin dhe te justifikuara nga interesi pub/ik ne nje shoqeri demokratike.

Ligjet**Nenet**

Neni 18.4

4. DSHAM, mund ta ndalojë aplikuesin në Qendrën e Mbajtjes në rastet kur konsideron të nevojshme dhe në bazë të një vlerësimi individual të secilit rast, dhe në qoftë se me masa të tjera alternative më pak shtrënguese alternative nuk mund të arrihet qëllimi i kufizimit të lirisë së lëvizjes, në rastet e mëposhtme:

4.1. për të përcaktuar ose verifikuar identitetin apo shtetësinë e tij/saj;

4.2. për të përcaktuar elementet në të cilat është bazuar aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare, e që nuk do të mund të siguroheshin pa kufizimin e lirisë së lëvizjes, sidomos kur ekziston rreziku i ikjes së aplikuesit;

4.3. kur është e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë kombëtare ose sigurisë publike;

4.4. për të vendosur, në kontekst të procedurës, për të drejtën e aplikuesit për të hyrë në territor;

4.5. kur ai ose ajo mbahet për qëllime të procedurës së kthimit, për të përgatitur kthimin dhe/ose kryer procesin e largimit, dhe kur organi kompetent mund të dëshmojë në bazë të kriterëve objektive, përfshirë edhe faktin se parashtuesi ka pasur tashmë mundësinë për të filluar procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare, se ka baza të arsyeshme për të besuar se personi po aplikon për mbrojtje ndërkombëtare vetëm sa për ta shtyrë ose penguar ekzekutimin e vendimit për kthim.

Neni 18.5

5. Masat tjera alternative të kufizimit të lirisë së lëvizjes së aplikueseve janë si në vijim:

5.1. ndalimi i lëvizjes nga Qendra për Azil;

5.2. ndalimi i lëvizjes jashtë hapësirës së caktuar;

5.3. paraqitja tek organi kompetent në kohën e caktuar;

5.4. dorëzimi i dokumenteve të udhëtimit, apo depozitimi i një garancioni financiar tek organi kompetent.

Ligji nr. 06/1- 026 për azil
Ligji nr. 06/1- 026 për azil

Ligji nr. 06/1- 026 për azil
Ligji nr. 06/1- 026 për azil

Neni 18

Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes

Ligji për Policinë Nr. 04/L-076

Ligji për Policinë Nr. 04/L-076

1.Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t'ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t'i arritur objektivat legjitime të policisë apo për t'i mbrojtur personat nga rreziku i përkohshëm.

2.Objektivat legjitime të policisë përfshijnë, por nuk kufizohen në mbrojtjen e personave nga fatkeqësitë, epidemitë, dhe rastet e tjera të rrezikut të pashmangshëm.

3.Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes të personit përfundon menjëherë pasi të arrihen objektivat legjitime të policisë lidhur me kufizimin e përkohshëm.

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar Në Çështjet Penale Nr. 04/L-213

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar Në Çështjet Penale Nr. 04/L-213

Neni 17.3

3. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka arsye për të besuar se personi nuk do të pranojë garancitë minimale për një gjykim të drejtë në shtetin kërkues, siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 13

Ne bis in idem

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar Në Çështjet Penale Nr. 04/L-213

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar Në Çështjet Penale Nr. 04/L-213

1. Ekstradimi nuk lejohet nëse është dhënë një vendim i formës së prerë nga organet gjyqësore vendore kundër personit të kërkuar për veprën apo veprat penale për të cilat kërkohet. Ekstradimi mund të lejohet nëse organet gjyqësore vendore kanë vendosur të mos fillojnë ose të ndërpresin procedurën gjyqësore në lidhje me veprën apo veprat e njëjta penale.

2. Ekstradimi nuk lejohet nëse është dhënë vendim i formës së prerë nga organet gjyqësore të një shteti të tretë kundër personit të kërkuar për veprën ose veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi dhe nëse ekziston një marrëveshje ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe atij shteti për njohjen dhe ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve penale.

Neni 27.1

27.1 Organi kompetent, tek i cili ka qenë e paraqitur kërkesa për tu pajisur me pasaportë e refuzon kërkesën në bazë të vendimit të gjykatës nëse :

LIGJI NR. 03/L-037 PËR
DOKUMENTET E
UDHËTIMIT
LIGJI NR. 03/L-037 PËR
DOKUMENTET E
UDHËTIMIT

a) kundër shtetasit, që ka bërë kërkesën për lëshimin e pasaportës është duke u zhvilluar procedurë penale respektivisht zhvillohet procedura për zgjidhjen e martesës si dhe njohjen e të drejtës prindërore, nëse gjykata kërkon ndalesën e lëshimit të pasaportës ;

b) ekzistojnë interesat e mbrojtjes së shtetit, të përcaktuara në ligj ;

c) shtetasit i është shqiptuar së paku dy herë dënimi me burg për veprat penale të prodhimit të kundërligjshëm dhe trafikimit të narkotikëve, falsifikim të parave, kontrabandim, falsifikim të dokumenteve, prodhim kundërligjor dhe trafikim të armëve apo eksplozivëve, kalim të kundërligjshëm të kufirit shtetëror, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit ndërkombëtar, financimit të veprimtarisë terroriste dhe vepra tjera penale në lidhje me shtetet e huaja,

Neni 27.2

LIGJI NR. 03/L-037 PËR
DOKUMENTET E
UDHËTIMIT
LIGJI NR. 03/L-037 PËR
DOKUMENTET E
UDHËTIMIT

Nëse gjykata ka nxjerrë aktgjykim të plotfuqishëm kundër shtetasit të bazuar në pikat a,b,c të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të njoftojë organin kompetent mbi refuzimin e kërkesës dhe për këtë duhet të japë arsytim.

Neni 27.3

LIGJI NR. 03/L-037 PËR
DOKUMENTET E
UDHËTIMIT
LIGJI NR. 03/L-037 PËR
DOKUMENTET E
UDHËTIMIT

Nëse ndonjëra nga arsyet nga pikat a,b,c, të paragrafit 1 të këtij neni, është paraqitur pas lëshimit të pasaportës, organi kompetent për dhënien e pasaportës duhet te nxjerri vendim mbi marrjen e pasaportës

Neni 27

1. Kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe përfshin, sipas protokollit përkatës, elementet e mëposhtme:

1.1. Mbajtjen me forcë të personit;

1.2. Përdorimin e detyruar të medikamenteve;

1.3. Imobilizimin;

1.4. Izolimin.

LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025
LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025

2. Kufizimi fizik zbatohet për periudha të shkurtra kohore me objektiva të qarta, sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Të gjitha procedurat e ndjekura për realizimin e kufizimit fizik dhe arsyet e ndërmarrjes së tyre përshkruhen në mënyrë të hollësishme në kartelën e pacientit.

3. Gjatë kufizimit fizik, kontakti i stafit të shërbimit të shëndetit mendor me klientin duhet të jetë aktiv dhe i vazhdueshëm, që shkon përtej monitorimit rutinë, sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Ndalohet përdorimi i kufizimit fizik si mjet ndëshkimi ose si mjet më lehtësues për stafin e shërbimit

5. Kufizimi fizik zbatohet në kushtet kur:

5.1. Autorizohet nga mjeku psikiatër me shkrim;

5.2. Kryhet në formën më pak kufizuese/shtrënguese që ofron siguri dhe kontroll të sjelljes agresive të pacientit;

Neni 12

Ligjshmëria e privimit nga liria dhe vendosja në procedurë të përshpejtuar

KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE
KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE

1. Askujt nuk mund t'i hiqet apo kufizohet liria, përpos rasteve dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj. 2. Çdo person i privuar nga liria me arrest ose me ndalim, ka të drejtë të kundërshtojë, sipas procedurës së paraparë me këtë Kod, ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij, për të cilën vendos gjykata në procedurë të përshpejtuar ose urdhëron lirimin e tij kur ndalimi është i paligjshëm.

Neni 26

Izolimi

LIGJI NR. 08/L-200 PËR
PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E
SËMUNDJEVE NGJITËSE
LIGJI NR. 08/L-200 PËR
PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E
SËMUNDJEVE NGJITËSE

1. Personat për të cilët konstatohet që kanë sëmundje ngjitëse me rrezik të përhapjes dhe sipas udhëzimit të mjekut duhet të izoloohen në klinikën infektive, repartet për trajtimin e sëmundjeve ngjitëse dhe institucionet tjera sipas nevojës:
1.1. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, bëjnë personat e sëmurë gjendja shëndetësore e të cilëve mundëson izolimin në kushte shtëpie, sipas udhëzimit të mjekut; 1.2. Personi i izoluar në kushte shtëpie, mbikëqyret nga mjeku në komunën ku jeton apo izolohehet; 1.3. Periudha e izolimit përfundon pas shërimit të personit dhe nuk paraqet rrezik të përhapjes së sëmundjes, pas konstatimit të mjekut.

decisionTitle*

decisionDescription*

Kërkuesi u ankua në bazë të Nenit 2 të Protokollit nr. 4 se ndalimi i largimit të tij nga territori i Bullgarisë ishte i pajustificuar dhe joproporcional.

STAMOSE v.
BULGARIA
(Application no.
29713/05) 27
November 2012

Kerkuesi pretendonte, në veçanti, se një ndalim për largimin e tij nga territori i Bullgarisë për një periudhë prej dy vjetësh për shkak të shkeljeve të ligjeve të imigracionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ishte i pajustificuar; se kjo ndalesë, e cila e kishte penguar atë të udhëtonte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku jetonte nëna dhe vëllai i tij, kishte përbërë një ndërhyrje të pajustificuar në jetën e tij familjare; dhe se në shqyrtimin e kundërshtimit të tij ligjor ndaj ndalimit gjykatat nuk e kishin shqyrtuar proporcionalitetin e saj.

Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4

decisionTitle***decisionDescription***

Z. Ján Čonka, Znj. Mária Ťonková, Znj. Nad'a Ťonková dhe Znj. Nikola Ťonková janë shtetas sllovakë me origjinë rome, të lindur në vitet 1960, 1961, 1985 dhe 1991 respektivisht. Dy aplikantët e parë janë prindërit e aplikantëve të tretë dhe të katërt. Aplikantët thonë se në disa raste ndërmjet marsit dhe nëntorit 1998 ata u sulmuan me dhunë nga skinheads në Republikën Sllovake. Në të vërtetë, në nëntor të vitit 1998, z. Ťonka ishte plagosur aq seriozisht në një sulm që ai duhej të shtrohej në spital. Policia ishte thirrur por nuk kishte pranuar të ndërhynte. Disa ditë më vonë zoti dhe znj. Ťonka ishin nënshtruar ofendimeve dhe kërcënimeve të rinovuara nga skinheads, por policia kishte refuzuar përsëri të ndërhyjë. Si rezultat i këtyre kërcënimeve të vazhdueshme, aplikantët kishin vendosur të iknin nga Sllovakia dhe të udhëtonin në Belgjikë, ku ata kishin ardhur në fillim të nëntorit 1998: Z. Ťonka dhe dy fëmijët e mitur më 6 nëntor dhe znj. Ťonka dy ditë më vonë.

ŤONKA v.
BELGIUM
(Application no.
51564/99) 5
February 2002

Ankuesit pretenduan se arrestimi i tyre në stacionin e policisë Ghent më 1 tetor 1999 kishte shkaktuar një shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës, pjesa përkatëse e së cilës thotë si vijon:

Gjykata në mënyrë unanime:

1. Vendos në mënyrë unanime **se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1** të Konventës;
2. Vendos në mënyrë unanime se nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 2 të Konventës;
3. Vendos në mënyrë unanime **se ka pasur shkelje të nenit 5 § 4** të Konventës;
4. Vendos me katër vota në tre se ka pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 të Konventës;
5. Vendos në mënyrë unanime që nuk ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës së marrë në lidhje me nenin 3;

decisionTitle***decisionDescription***

Ankuesi ankohet sipas nenit 5 § 1 të Konventës, se ndalimi i tij i vazhdueshëm (të paktën nga 20 korriku 2010 ose, ndryshe, nga 14 gushti ose 7 tetori 2010) nuk ishte në përputhje me ligjin.

Kjo ankesë bie për t'u shqyrtuar sipas nenit 5 § 1 (c) të Konventës.

Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 5 § 4 të Konventës se ligjshmëria e paraburgimit të tij të vazhdueshëm

DELIJORGJI v.

ALBANIA (

Application no.

6858/11) 28 April

2015

që është shqyrtimi i kërkesës së tij të parë për lirim, nuk u trajtua me shpejtësi.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT,

Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës lidhur me paraburgimin e ankuesit nga 24 nëntor 2010 deri më 12 mars 2012;

Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës;